ALBtelecom sh.a.
NR. 2110 PROT.
DATË 20-3-2019

**Albtelecom sh.a**

**Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur**

MAZARS

## PËRMBAJTJA


RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR ... 2
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR ... 3
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES ... 4
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE ... 5
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE ... 6
PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA ... 7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE ... 8
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM ... 8
2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE ... 8
3. ZBATIMI I STANDARTEVE TE REJA DHE TË RISHIKUAR NDERKOMBËTARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR ... 11
4. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL ... 13
5. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE ... 24
6. AKTIVET AFATGJATA JOMATERIALE ... 25
7. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME AFATGJATA ... 26
8. INVENTARI ... 26
9. LLOGARITË E ARKËTUESHME AFATSHKURTRA ... 26
10. PARAPAGIMET DHE SHPENZIMET E SHTYRA ... 28
11. MJETET MONETARE ... 28
12. KAPITALI AKSIONAR ... 29
13. HUATË ... 30
14. PROVIZIONET ... 32
15. LLOGARI TË PAGUESHME TREGTARE ... 32
16. GRANTET DHE TË ARDHURAT E SHTYRA ... 33
17. TË TJERA LLOGARI TË PAGUESHME ... 33
18. SHITJET NETO ... 34
19. SHPENZIMET ... 35
20. TË ARDHURA DHE SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT ... 37
21. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE ... 37
22. TATIMI MBI FITIMIN ... 38
23. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA ... 39
24. INSTRUMENTAT FINANCIARË MANAXHIMI I RISKUT FINANCIAR ... 40
25. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA ... 44
26. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT ... 44

MAZARS

**RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**Për Menaxhimin dhe aksionerët e Shoqërisë Albtelecom sh.a**

**Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albtelecom sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

**Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

MAZARS SHPK
RR. EMIN DURAKU - PALL. "BINJAKET" N°5 - TIRANA, ALBANIA
TEL/FAX: +355 42 278 015 - +355 42 222 889- www.mazars.al

Praxity. GLOBAL ALLIANCE OF INDEPENDENT FIRMS

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

15 mars 2019

MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket", No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

**Teit Gjini**
Auditues Ligjor

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**
**Më 31 dhjetor 2018**
**(000/Lekë)**

| | Shënime | 31 dhjetor 2018 | 31 dhjetor 2017 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVE** | | | |
| **Aktivet afatgjata** | | | |
| Aktivet afatgjata materiale | 5 | 22,976,710 | 25,310,407 |
| Aktivet afatgjata jomateriale | 6 | 1,213,612 | 1,428,289 |
| Të tjera llogari të arkëtueshme | 7 | 29,119 | 34,868 |
| **Totali i aktiveve afatgjata** | | **24,219,441** | **26,773,564** |
| **Aktivet afatshkurtra** | | | |
| Inventarë | 8 | 352,078 | 362,869 |
| Llogari të arkëtueshme tregtare | 9 | 890,121 | 1,410,751 |
| Tatim fitimi i parapaguar | 22 | 39,714 | 70,852 |
| Llogari të arkëtueshme të tjera | 9 | 128,647 | 100,205 |
| Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra | 10 | 230,434 | 186,637 |
| Mjetet monetare në arkë e në bankë | 11 | 163,847 | 151,204 |
| **Totali i aktiveve afatshkurtra** | | **1,804,841** | **2,282,518** |
| **Totali i aktiveve** | | **26,024,282** | **29,056,082** |
| **KAPITALI** | | | |
| Kapitali aksionar | | 18,250,000 | 18,250,000 |
| Rezerva rivlerësimi | | 2,776,815 | 2,779,021 |
| Rezerva te ligjore | | 232,302 | 232,302 |
| Fitime të mbartura | | (13,041,927) | (12,811,265) |
| **Totali i kapitalit** | 12 | **8,217,190** | **8,450,058** |
| **DETYRIMET** | | | |
| **Detyrime afatgjata** | | | |
| Hua afatgjata | 13 | 9,468,281 | 11,636,595 |
| Provizione | 14 | - | 35,765 |
| Llogari te pagueshme afatgjata | 15 | 581,117 | 232,075 |
| Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime | 16 | 332,718 | 343,723 |
| Tatim fitimi i shtyre mbi fitimin | 22 | 1,048,868 | 1,175,429 |
| **Totali i detyrimeve afatgjata** | | **11,430,984** | **13,423,587** |
| **Detyrime afatshkurtra** | | | |
| Hua afatshkurtra | 13 | 3,316,675 | 3,023,449 |
| Llogari të pagueshme tregtare | 15 | 2,728,904 | 3,687,840 |
| Provizione | 14 | 104,646 | 304,163 |
| Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime | 16 | 69,139 | 27,976 |
| Llogari të pagueshme të tjera | 17 | 156,744 | 139,009 |
| **Totali i detyrimeve afatshkurtra** | | **6,376,108** | **7,182,437** |
| **Totali i detyrimeve** | | **17,807,092** | **20,606,024** |
| **Totali i kapitalit dhe detyrimeve** | | **26,024,282** | **29,056,082** |

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

## PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**(000/Lekë)**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 |
|---|---|---|---|
| Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit | 18 | 8,134,336 | 8,142,767 |
| Kosto e sherbimeve te shitura | 19 | (5,406,953) | (5,635,703) |
| **Total të ardhura** | | **2,727,383** | **2,507,064** |
| Shpenzimet e shitjes dhe te shperndarjes | 19 | (1,308,859) | (1,364,629.0) |
| Shpenzime te pergjithshme dhe administrative | 19 | (1,571,414) | (1,782,734.0) |
| Te ardhura/shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit | 20 | (205,778) | 205,052.0 |
| **Fitimi operativ** | | **(358,668)** | **(435,247)** |
| Shpenzime/ te ardhura per interesa | 21 | (1,045,855) | (1,172,997) |
| Te ardhura/shpenzime financiare neto | 21 | 1,074,781 | 468,917 |
| **Fitimi/humbja para tatimit** | | **(329,742)** | **(1,139,327)** |
| **Shpenzimi i tatimit mbi fitimin** | 22 | - | - |
| Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin | | - | |
| Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë | | - | |
| **Fitimi/humbja e vitit** | | **(329,742)** | **(1,139,327)** |

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

## PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**(000/Lekë)**

| | | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 |
|---|---|---|---|
| | | (329,742) | (1,139,327) |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse** | | | |
| *Zëra që mund të riklasifikohen më vonë ne fitim/humbje:* | | | |
| *Zëra që nuk do të riklasifikohen më vonë ne fitim/humbje:* | | | |
| Tatimi fitimi i shtyrë që regjistrohet direkt ne te ardhura te tjera gjitheperfshirese | 22 | 126,561 | (346,424) |
| Rivlerësimi makineri e pajisjeve | | - | 2,181,929 |
| **Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin** | | **126,561** | **1,835,505** |
| **Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse** | | **(203,181)** | **696,178** |

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

## PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**
**(000/Lekë)**

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 |
|---|---|---|---|
| **Flukset e parasë nga aktivitetet operative** | | | |
| **Fitimi para tatimit** | | (329,742) | (1,139,327) |
| *Axhustime për zërat jo-monetare:* | | | |
| Amortizimi | | 1,861,570 | 1,979,795 |
| Nxjerrja jashtë përdorimit e mjeteve fikse, neto nga fitimi kapital | | 220,315 | 28,379 |
| Zhvlerësimi I llogarive te arketueshme | | 251,094 | 212,200 |
| Provizione | | (235,282) | 35,994 |
| Të ardhura nga interesat | | (69) | (51) |
| Shpenzime për interesa | | 1,069,663 | 1,196,396 |
| Forex | | (1,039,770) | (485,125) |
| *Ndryshimi ne kapitalin qarkullues* | | | |
| Rënie/(rritje) në inventar | | 10,791 | 77,791 |
| Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera | | 193,676 | 303,336 |
| Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera | | (166,226) | (2,236,618) |
| **Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative** | | **1,836,020** | **(27,230)** |
| Interesa të paguara | | (488,433) | (789,545) |
| **Mjetet monetare neto nga aktivitetet operative** | | **1,347,587** | **(816,775)** |
| **Aktivitetet investuese** | | | |
| Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale | | (604,997) | (813,203) |
| Shitje e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale | | 1,071,486 | 1,170 |
| (Ripagim)/ të hyrat neto nga llogarite afatgjate | | 5,749 | 2,135 |
| Interesa të arkëtuara | | 69 | 51 |
| **Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues** | | **472,307** | **(809,847)** |
| **Aktivitetet financuese** | | | |
| (Ripagim)/ të hyrat neto nga huatë afatgjata | | (1,522,370) | (1,228,980) |
| (Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkurtër | | (288,004) | (431,271) |
| Emetim aksionesh | | - | 3,250,000 |
| **Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues** | | **(1,810,374)** | **1,589,749** |
| **Ndryshimi neto i mjeteve monetare** | | **9,520** | **(36,873)** |
| Mjetet monetare në fillim të periudhës | | 151,204 | 164,042 |
| Ndryshimi në kursin e kembimit | | 3,123 | 24,035 |
| **Mjetet monetare në fund të periudhës** | 11 | **163,847** | **151,204** |

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

## PASQYRA E LEVIZJES SË KAPITALEVE TË VETA
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

**(000/Lekë)**

| | Kapitali aksionar | Rezerva të tjera | Rezerva rivlerësimi | Rezerva ligjore | Fitim /humbje të akumuluara | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1 janar 2017** | **15,000,000** | **23,153** | **573,939** | **232,302** | **(11,325,514)** | **4,503,880** |
| Fitimi/(humbja) e vitit | | | | | (1,139,327) | **(1,139,327)** |
| Emetim i kapitalit aksionar | 3,250,000 | | | | | **3,250,000** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | | | 2,181,929 | | (346,424) | **1,835,505** |
| **31 dhjetor 2017** | **18,250,000** | **23,153** | **2,755,868** | **232,302** | **(12,811,265)** | **8,450,058** |
| Efekte ne ndryshim ne politika kontabel dhe gabime te periudhave te meparshme | | | | | (29,687) | **(29,687)** |
| Fitimi/(humbja) e vitit | | | | | (329,742) | **(329,742)** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse - tatimi I shtyre | | | | | 126,561 | **126,561** |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse - realizim rezerve | | | (2,206) | | 2,206 | - |
| **31 dhjetor 2018** | **18,250,000** | **23,153** | **2,753,662** | **232,302** | **(13,041,927)** | **8,217,190** |

*Shënimet shpjeguese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.*

Pasqyrat Financiare të vitit 2018, së bashku me shënimet u aprovuan nga manaxhimi në datë 15/03/2019 dhe u firmosën në emër të tij nga:

**Burak Yurtsever**
**Zv/Drejtor i Përgjithshëm**

**Myrvete FERHATI**
**Dr/ Drejtorisë Kontabilitetit dhe Taksave**